



10. BeShtKraK

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, INFRASTRUKTURËS, TRANSPORTIT DHE
MJEDISIT

Nr. 5248/4 Prot.

Lezhë, më 26.05.2026

Lënda: Procesverbal

Mbajtur më 26.05.2026

Sot më 26.05.2026 ora 11:00, në bibliotekën “at Gjergj Fishta” është mbajtur dëgjesa publike me qëllim miratimin e projekt- vendimit “Për disa ndryshime në vkb nr.104, datë 16.11.2025 “Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave të shërbimeve publike dhe administrative, lehtësirave fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaltive ndaj kundravajtësve”

Dëgjesa u drejtua nga :

- Kryetari i Këshillit Bashkiak z.Ndue Luli;
- Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike,Infrastrukturës,Transportit dhe Mjedisit z.Jurgen Marku;

Pjesë e diskutimit ishin dhe grupet e interesit persona apo administratorë të agjencive dhe shtëpive funerale si “Fildana”, “Zefi”, “Suli” por dhe perfaqësues të institucioneve të ndryshme dhe grupe të interesit.

Hapja e mbledhjes u realizua nga Kryetari i Këshillit Bashkiak z.Ndue Luli, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike,Infrastrukturës,Transportit dhe Mjedisit z.Jurgen Marku i cili bëri një përmbledhje të secilës nga tarifave që do të shtohen në vkb nr.104 datë 16.11.2025 “Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave të shërbimeve publike dhe administrative, lehtësirave fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaltive ndaj kundravajtësve” si më poshtë :

- Gjobë për mospajisjen me licencë për agjenci funerale – 20.000 lekë;
- Gjobë për mospajisjen me certifikatë për agjenci funerale- 10.000 lekë;
- Gjobë për ekspozim të materialeve – 20.000 lekë;
- Ekspozim i mjetti autofunebër- 20.000 lekë;
- Gjobë për shkeleje të kushteve të licencës/ certifikatës – 20.000 lekë;

Dhe informimi për gjokat në lidhje me hedhjen e mbetjeve.

- Gjobë për hedhjen jashtë orarit të caktuar – 10.000 lekë familjarë / 20.000 lekë biznese;

- Gjobë e mbetjeve jashtë pikave të grumbullimit të miratuara nga Bashkia - 10.000 lekë familjarë / 20.000 lekë biznese;
- Hedhja e mbetjeve pa qese - 10.000 lekë familjarë / 20.000 lekë biznese;


Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike,Infrastrukturës,Transportit dhe Mjedisit theksoi se qëllimi i këtij ndryshimi është për shkak se:

Është konstatuar ushtrimi i aktivitetit të agjencive funerale pa u pajisur me licencat dhe certifikatat përkatëse, si dhe mosrespektimi i kushteve dhe standardeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Gjithashtu, është evidentuar ekspozimi i materialeve dhe mjeteve autofunebër në kundërshtim me rregullat dhe kriteret e miratuara nga Bashkia Lezhë.Në kuadër të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve funerale, garantimit të standardeve të nevojshme për ushtrimin e këtij aktiviteti dhe rritjes së kontrollit institucional, propozohet vendosja e penaliteteve administrative për subjektet kundravajtëse.

Sa i përket penaliteteve në lidhje me hedhjen e mbetjeve, qëllim i këtyre ndryshimeve është ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe subjekteve lidhur me respektimin e rregullave për administrimin e mbetjeve urbane, ndalimin e hedhjes së tyre në vende të papërshtatshme dhe mbrojtjen e mjedisit.

Përfaqësuesit e agjencive funerale dhe grupet e interesit paraqitën sugjerimet dhe shqetësimet e tyre pasi disa prej tyre nuk ishin dakord.Përfaqësusi i agjenci funerale Nika, shprehu shqetësimin e tij në lidhje me logot në makinën që përdorej nga ana e tij për transportin e mallrave dhe ju bë me dije nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike,Infrastrukturës,Transportit dhe Mjedisit se makinat të cilat ekspozohen dhe janë në shërbim të biznesit të tij nuk duhet të kenë asnjë logo. Po ashtu sugjerime u dhanë dhe nga përfaqësuesi i shtëpisë funerale Bezhi.Të gjitha këto sugjerime u sqaruan nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike,Infrastrukturës,Transportit dhe Mjedisit.

Në përfundim të dëgjësës publike, Kryetari i Këshillit Bashkiak falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe kontributin në diskutim, duke theksuar se të gjitha sugjerimet dhe rekomandimet do të merren në konsideratë përpara miratimit përfundimtar të projekt-vendimit nga Këshilli Bashkiak.





Drejtuesi i mbledhjes

Jurgen MARKU

Mbajtësi i procesverbalit

Klara NDOKA

Sekretarja e Këshillit Bashkiak

Florida ÇUNAJ